



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Ismet Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Adresa: Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës Rr. Nënë Tereza – Sheshi Ibrahim Rugova – 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës (KRK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Kuvendit të Republikës së Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KRK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Kuvendit të Republikës së Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Kuvendit të Republikës së Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit kemi vërejtur se procesi i menaxhimit financiar dhe kontrollit ishte përcjellë me mangësi në ekzekutimin e pagesave me vendime gjyqësore si dhe dobësive në procesin e vlerësimit. Mangësitë e identifikuara janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2020 ishte 2,342,400€, prej tyre ishin shpenzuar 1,040,790€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, furnizime për zyrë, shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse dhe shërbimet komunale. Në këtë kategori kemi testuar 12 mostra për teste substanciale në vlerë 275,707€ si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A1 - Ekzekutimi i pagesës në bazë të vendimit gjyqësor

Gjetja

Sipas nenit 47.40 të UOPP, një kontratë duhet të ekzekutohet në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës dhe planin e menaxhimit të kontratës. Sipas nenit 22.4 të Kontratës së nënshkruar në mes Kuvendit të Republikës së Kosovës (KRK) dhe OE furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar, do të refuzohen. Ndërsa, neni 27 i po të njëjtës kontratë specifikon se në cilat situata autoriteti kontraktues mund ta ndërpresë kontratën.

Më 24.06.2015, KRK kishte lidhur kontratë për "Liferimin, testimin dhe implementimin në tërësi të sistemit me pajisje portative (mobile) për qasje dhe punë në distancë për nevoja të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës". Operatori ekonomik ia kishte dërguar pajisjet e kontraktuara Kuvendit më 03.07.2015, dhe komisioni i pranimi dhe menaxheri i kontratës kishin bërë raportin e pranimi të pajisjeve, me vërejtjen se pajisjet e dërguara nuk i përmbushin kërkesat e kontratës. Më 23.07.2015 nga operatori ishte kërkuar që t'i tërheq pajisjet.

Operatori nuk ishte përgjigjur në kërkesat e autoritetit kontraktues, dhe nga këto arsye, më 21.08.2015 kishte ardhur deri te ndërprerja e njëanshme e kontratës nga ana e KRK. Më 30.05.2016, KRK ia kishte kthyer të gjitha pajisjet e pranuar kontraktorit. Për shkak të mospajtimeve në mes palëve, kontraktori kishte paditur KRK-në dhe kishte fituar kontestin gjyqësor në vitin 2020. Përkundër ankesave të KRK në tri instanca gjyqësore, përpjekjet kishin rezultuar të pa sukseshme, dhe kontestin gjyqësor e kishte fituar OE.

Gjatë vitit me dt. 08.12.2020 Vendimin gjyqësor, kontraktori e kishte dërguar në Thesar për ekzekutim të pagesës, dhe Thesari bazuar në nenin 40 të LMFPP, kishte ekzekutuar pagesën në vlerë prej 130,740€. Prej shumës së paguar, borxhi kryesor ishte 87,960€, interesi 42,780€ dhe shpenzimet tjera gjyqësore 3,445€.

Pas pagesave të kryera nga Thesari, operatori ia kishte dorëzuar Kuvendit shumicën e pajisjeve të kontraktuara, por jo të gjitha.

Në ndërkohë, pasi që kishte humbur kontestin gjyqësor, Kuvendi më 27 korrik 2020 kishte ushtruar padi gjyqësore në Gjykatën Themelore, ndaj operatorit për pasurim të pa bazë, ku kërkohet që pajisjet e kontraktuara t'i dorëzohen nga ana e operatorit, por kontesti ende nuk është shqyrtuar nga Gjykata.

Ndikimi

Konkluzioni i auditimit është se kjo kontratë është përcjellë me shumë paqartësi, dhe për pasojë janë paguar shpenzime të konsiderueshme shtesë për pagesën e interesave dhe shpenzimeve tjera gjyqësore, gjë që ka rritur dukshëm koston e kontratës bazë. Për më tepër, përkundër këtyre pagesave, ende nuk janë pranuar të gjitha pajisjet e kontraktuara.

Rekomandimi A1

Sekretari i përgjithshëm duhet të kërkoj nga operatori ekonomik dorëzimin e të gjitha pajisjeve të kontraktuara, si dhe të forcoj kontrollet lidhur me pranimin dhe vlerësimin me kohë të karakteristikave teknike të pajisjeve/mallrave të kontraktuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen).

2.1.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 487,793€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 90,256€. Ato kanë të bëjnë me renovimin e ndërtesës së Kuvendit, digjitalizimin e arkivës së Kuvendit, krijimin e qendrës së të dhënave, sistemit të integruar WIFI si dhe pajisjeve dezinfektuese. Në këtë kategori, kemi testuar pesë (5) mostra për teste substanciale në vlerë 77,860€, si dhe katër (4) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Dobësi në vlerësimin e ofertës

Gjetja

Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Ndërsa te neni 9.1 dhe 9.2 i dosjes së tenderit, njëra prej kërkesave ishte, dëshmi (kontrata e punës) për përvojën e punës (së paku 3 vjet) në lëmin përkatës.

Në projektin "Renovimi i ndërtesës - Punët e paparashikuara në projektin kryesor" në vlerë 51,780€, OE për inxhinierin e diplomuar të makinerisë në vend të kontratës kishte ofruar një referencë e cila nuk ofronte dëshmi për periudhën e përvojës së kërkuar.

Bazuar në këtë, ne kemi vërejtur se nuk janë përmbushur kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, për të cilat komisioni i vlerësimit të ofertave kishte vlerësuar si të përgjegjshëm duke rekomanduar nënshkrimin e kontratës.

Kjo kishte ndodhur për shkak se komisioni me rastin e shqyrtimit të ofertave kishte konsideruar se dokumentet e ofruara janë të mjaftueshme dhe plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë.

Ndikimi

Përzgjedhja e OE fitues të cilët nuk përmbushin kriteret e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit, rezulton me shpërblimin e OE në kundërshtim me kërkesat ligjore. Kjo mund të rrezikojë cilësinë e shërbimeve dhe arritjen e objektivave të parapara në projekt.

Rekomandimi A2

Sekretari i Përgjithshëm duhet t'i forcoj kontrole në procesin e vlerësimit të ofertave, në mënyrë që përzgjedhja e fituesve bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen).

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	11,155,483.00	8,651,582.26	8,076,191.36	8,099,896.78	8,851,012.96
Grante Qeveritare – Buxheti	11,155,483.00	8,651,582.25	8,076,191.36	8,099,896.78	8,851,012.96
Donacionet e jashtme	0.00	0.01	0.00	0.00	0.00

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 2,503,902€. Fillimisht ishte zvogëluar me rishikim të buxhetit për vlerën 1,135,949€, ndërsa me shkurtime buxhetore sipas vendimeve të Qeverisë për vlerën 1,367,953€.

Në vitin 2020, KRK ka shpenzuar 93% të buxhetit përfundimtar apo 8,076,191€, me një ulje 1% në krahasim me vitin 2019. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	11,155,483.00	8,651,582.26	8,076,191.36	8,099,896.78	8,851,012.96
Pagat dhe mëditjet	7,633,083.00	6,878,698.66	6,877,325.80	6,175,249.60	6,837,448.34
Mallrat dhe shërbimet	2,101,400.00	1,047,625.93	882,853.57	1,278,148.82	1,551,315.74
Komunalitë	241,000.00	167,465.17	157,936.39	167,829.05	179,444.34
Subvencionet dhe transferet	70,000.00	70,000.00	67,820.00	103,360.17	128,312.60
Investimet Kapitale	1,110,000.00	487,792.50	90,255.60	375,309.14	154,491.94


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 754,385€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimit të Qeverisë nr.09/50. Vlera e shpenzuar në këtë kategori ishte 6,877,326€;


- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,053,774€. Fillimisht si rezultat i ndryshim dhe plotësimit të Ligjit Nr.07/I-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 është bërë zvogëlimi i buxhetit për 634,000€. Pastaj me Vendim të Qeverisë nr.01/46 është zvogëluar buxheti për 270,018€, dhe vendimin e Qeverisë nr.09/50, ishte zvogëluar për 149,756€. Vlera e shpenzuar në këtë kategori ishte 882,854€;
- Buxheti final për komunalitet në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për vlerën 73,535€. Ky zvogëlim ishte rezultat i rishikimit të buxhetit në vlerë 44,948€ dhe i vendimit të qeverisë nr.09/50 për vlerën 28,587€. Vlera e shpenzuar në këtë kategori ishte 157,936€;
- Buxheti final në raport me atë fillestar të kategorisë së subvencioneve dhe transfereve nuk kishte ndryshime, ndërsa ishin shpenzuar 67,820€; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për vlerën 622,207€. Me ndryshim dhe plotësimit të Ligjit Nr.07/I-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 ishte zvogëluar për 457,000€. Ndërsa, me dy vendime të qeverisë ishte zvogëluar në vlerë 215,207€, së pari me vendim nr.01/46 ishte zvogëluar 118,000€ dhe vendimin e dytë nr.09/50 ishte zvogëluar 47,207€. Vlera e shpenzuar në këtë kategori ishte 90,256€.

Vlen të theksohet që KRK, gjatë vitit 2020 nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve kishte shpenzuar 63,603€, të cilat kishin të bëjnë kryesisht për furnizim me pajisje mbrojtëse kundër përhapjes së virusit COVID 19.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



KRK për vitin 2020 nuk kishte realizuar të hyra, për dallim nga viti 2019 ku të hyrat ishin 3,150€, të cilat ishin nga rimbursimi prej kompanisë së sigurimit.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	0.00	0.00	0.00	3,150.00	24,273.87
Të hyrat jo tatimore	0.00	0.00	0.00	3,150.00	0.00
Të hyrat tjera	0.00	0.00	0.00	0.00	24,273.87

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të KRK ka rezultuar në katër (4) rekomandime kryesore. KRK kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu, ka përgatitur raportet periodike rreth zbatimit të rekomandimeve.

Deri në fund të vitit 2020, KRK ka zbatuar të gjitha rekomandimet e vitit të kaluar, siç është paraqitur në Grafikon 3, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën e rekomandimeve nr.4.

Grafiku 3. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Subvencionet dhe transferet	Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit në bashkëpunim me Kryesinë e Kuvendit, të siguroj se përzgjedhja e përfituesve të mjeteve nga subvencionet bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara me rregullore.	Janë marrë veprime që të respektohen kriteret e përcaktuara në Rregulloren e miratuar nga Kryesia e Kuvendit dhe është plotësuar dhe ndryshuar Rregullorja për Shpenzimet e Buxhetit të Kuvendit nga kategoria subvencione dhe transfere.	I zbatuar
2.	Subvencionet dhe transferet	Sekretari i Përgjithshëm të siguroj forcimin e kontrolleve në fushën e monitorimit të përfituesve të	Janë marrë veprime për kontrollin e monitorimit të përfituesve të	I zbatuar

		subvencioneve, për sigurimin e dëshmimeve përkatëse lidhur me shfrytëzimin e mjeteve nga OJQ-të, në përputhje me qëllimin e dhënë.	subvencioneve.	
3.	Investimet kapitale	Sekretari i Përgjithshëm, duhet të siguroj se kryerja/pranimi i punëve bëhet sipas pozicioneve të kontraktuara, në të kundërtën, ndryshimet e pozicioneve duhet të aprovohen paraprakisht.	Janë marrë veprime që të gjitha punët të kryhen në pajtim me kontratën. Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur në ndonjë parregullësi.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që objekti i Kuvendit të Kosovës i trashëguar si pasuri kapitale, të regjistrohet sa më parë në regjistër të pasurisë.	Kuvendi përmes kompanisë së kontraktuar kishte bërë vlerësimin e ndërtesës dhe oborrit të Kuvendit dhe e kishte regjistruar në SIMFK.	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Sekretari i përgjithshëm duhet të kërkoj nga operatori ekonomik dorëzimin e të gjitha pajisjeve të kontraktuara, si dhe të forcoj kontrollet lidhur me pranimin dhe vlerësimin me kohë të karakteristikave teknike të pajisjeve/mallrave të kontraktuar.
2.	Investimet kapitale	Sekretari i Përgjithshëm duhet t'i forcoj kontrolle në procesin e vlerësimit të ofertave, në mënyrë që përzgjedhja e fituesve bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shkelqim Xhema, Udhëheqës i Auditimit



Shemsije Llugiqi, Udhëheqëse e ekipit



Refiqe Morina, Anëtare e ekipit



Leonora Hasani, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATË PRANUAR DORËZUAR: DATE RECEIVED / SUBMITTED: 07 2021			
Nr. Njesia Org. Jedim. Org. Unit	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Nr. Stranica No. Pages
05	47	1087	1



KUVENDI I KOSOVËS SEKRETARIA	SKUPŠTINA KOSOVA SEKRETARIAT	ASSEMBLY OF KOSOVO SECRETARIAT
Nr. 1226/21 ZS		
Dt. 05.07 2021		
Prishtinë - Pristina		

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Kuvendi - Skupština - Assembly

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

I/E nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Kuvendit të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Ismet Krasniqi,

Sekretar i Përgjithshëm, Kuvendi i Republikës së Kosovës

Data: 05. Korrik. 2021, Prishtinë,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁷ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.